

VENDIM
Nr. 355, datë 25.6.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS ‘ENGJËLL AGALLIU’, NË LAGJEN ‘18
TETORI’, BASHKIA DIMAL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës ‘Engjëll Agalliu’, në lagjen ‘18 Tetori’, Bashkia Dimal”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Dimal.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 190 833 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 190 833 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Dimal.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Dimal.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Dimal.

8. Bashkia Dimal kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Dimal.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat dhe Drejtoria Vendore Kuçovë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Dimal, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Dimal, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Dimal, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat dhe Drejtoria Vendore Kuçovë, Agjencia Shtetërore për

Shpronësimin, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR
REALIZIMIN E PROJEKTTI “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS ‘ENGJËLL AGALLIU’, NË LAGJEN, ‘18 TETORI’, BASHKIA DIMAL”**

NR.	P R O N A R I			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									V L E R Ë S I M E T P Ë R S H P R O N Ë S I M							SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)	
													“ARË”			“TRUALL”					VLERA TOTALE (lekë)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	“Arë” (m2)	“Truall” (m2)	“Ndërtesë” (m2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë / m2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë / m2)	Vlera (lekë)		
1	Kleanthi	Xhelal	Daulle	Urë Vaigurore	3561	1238/55	Arë	1320	1320			8	192	24.7	311	7682			7682	Konfirmuar nga ASHK-ja	
2	Loni	Vasil	Daka	Urë Vaigurore	3561	1238/85	Arë	850	850			10	181	68	311	21148			21148	Konfirmuar nga ASHK-ja	
3	Vasillaq	Vangjel	Strora	Urë Vaigurore	3561	1238/66	Arë+truall	397	197	200	140	9	21	43	311	13373			13373	Konfirmuar nga ASHK-ja	
	Olgerta	Nuri	Strora																	Konfirmuar nga ASHK-ja	
4	Pandeli	Miti	Cinari	Urë Vaigurore	3561	1238/22	Arë	990	990			1	150	85	311	26342			26342	Konfirmuar nga ASHK-ja	
5	Hektor	Nuri	Agalliu	Urë Vaigurore	3561	1238/47	Arë	362.7	202.7	160	104.1	8	181	45	311	13995			13995	Konfirmuar nga ASHK-ja	
	Aferdita	Nuri	Salillari																	Konfirmuar nga ASHK-ja	
6	Dhimiter	Dine	Qevani	Urë Vaigurore	3561	1238/54	Arë	480	480			8	191	29	311	9019			9019	Konfirmuar nga ASHK-ja	
7	Arqile	Lipi	Larushi	Ure Vaigurore	3682	1/508	Truall	300		300		6	224				27.4	2375	65075	65075	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Koli	Lipi	Larushi																		
	Antoneta	Lipi	Mjeshtri																		
	Fotini	Lipi	Larushi																		
	Katerina	Koli	Larushi																		
	Ngjelina	Lipi	Tutulani																		
	Stasini	Lipi	Semani																		
8	Staverlina	Lipi	Agalliu	Ure Vaigurore	3682	1/509	Truall	300		300		6	225				14.4	2375	34200	34200	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Arqile	Lipi	Larushi																		
	Koli	Lipi	Larushi																		
	Antoneta	Lipi	Larushi																		
	Fotini	Lipi	Ferro																		
	Katerina	Koli	Larushi																		
	Ngjelina	Lipi	Tutulani																		
Stasini	Lipi	Semani																			
Staverlina	Lipi	Agalliu																			
VLERA TOTALE																91558			99275	190833	